



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:069011
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05702384

Pml.nr.304/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj kryetare, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit N. V., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.6 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale dëmtimi i varrezave apo kufomave nga neni 413 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit av. Shemsedin Piraj, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.533/2022 të datës 5.4.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.366/2024 të datës 25.4.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17.5.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit N. V. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.533/2022 të datës 5.4.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.366/2024 të datës 25.4.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr. 533/2022 të datës 5.4.2024, të pandehurve J. V. dhe N. V., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.6 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe veprës penale dëmtimi i varrezave apo kufomave nga neni 413 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t'iu zgjasë nga data 6.4.2024 deri më datën 5.6.2024. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 184 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.3 të Kodit të Procedurës penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.nr.366/2024 të datës 25.4.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit N. V. dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit N. V. av.Shemsedin Piraj, për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 432 par. 1 nën par. 1.1 të KPP si dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore nga neni 432 par. 1 nën par. 1.3 të KPP, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara ashtu që të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti të lirohet për t'u mbrojtur në liri ose që kjo masë t'i zëvendësohet me ndonjë masë alternative si arresti shtëpiak.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.127/2024 të datës 16.5.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë në rastin e vazhdimit të paraburgimit nuk kanë dhënë fare arsye konkrete dhe të pranueshme sa i përket bazave ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e zbatimit të kësaj mase, ku vëllimi i provave të prezantuara si në shkresat e lëndës në pjesën dërmuese ka përfunduar dhe se vazhdimi i paraburgimit më nuk është i arsyeshëm. Të pandehurit i dihet identiteti si dhe vendbanimi dhe duke pasur parasysh se është njeri familjarë, pa precedent penal, se në ambientin ku jeton dhe vepron cilësohet si njeri me sjellje të mira duke mos ra ndesh me asnjë normë shoqërore assesi nuk mund të flitet se po qe se ndaj tij në vend të masës së shqiptuar të vazhdimit të paraburgimit të gjej zbatim masa alternative ku nga këto masa veçon përshtatshmërinë e masës së arrestit shtëpiak, me që e njëjta bazuar në kufizimet në përmbajtjen e masës, do të ishte garanci e mjaftueshme që procedura penale të ketë rrjedhën e saj normale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet gjatë shqyrtimit gjyqësorë i cili është në vijim e sipër, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1. nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, motivi-përfitimi i dobisë pasurore, mënyra dhe rrethanat në të cilat dyshohet se janë kryer veprat penale po ashtu edhe fakti se çështja është në fazën e shqyrtimit gjyqësorë, vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.304/2024, më 17.5.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj